

KQZ
U PROTOKOLLUA
Nr. 7407 Prot.
Datë, më 2.11.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 601/35 Prot.

Tiranë më datë 02.11.2023

Lënda: Dërgohet vendimi “ Për miratimin e rezultateve të verifikimit”

KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE

TIRANË

Në përgjigje të kërkesës suaj, nr.4100 prot., datë 24.04.2023, bashkëlidhur ju dërgojmë vendimin “ Për miratimin e rezultateve të verifikimit”, në zbatim të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për të dhënat e plotësuar, në formularin e vetëdeklarimit datë 26.03.2023 të regjistruar me numër unik identifikimi BR-PS-17366, nga subjekti vetëdeklarues Kreshnik Hajdari, me atësi Riza dhe amësi Halime, lindur më 29.07.1982 në Kutalli, Kuçovë, me nr.personal ID: I20729060L.

Në përfundim të vendimmarrjes suaj, si organi përgjegjës për zbatimin e ndalimeve, kërkojmë të na informoni, mbi verifikimin e kushteve të ndalimit dhe masat e aplikuar, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V-së të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
DREJTORIA E KOORDINIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I DEKRIMINALIZIMIT

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E REZULTATEVE TË VERIFIKIMIT

Në Tiranë sot më datë 02 Nëntor 2023.

Unë Kostaq Beluri, Prokuror/Drejtor në Prokurorinë e Përgjithshme, në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, Vendimit Nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe Urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm nr. 42, datë 11.02.2020, pika 2, pasi shqyrtova aktet e verifikimit për subjektin vetëdeklarues **Kreshnik Hajdari**,

K O N S T A T O V A :

1. Subjekti Kreshnik Hajdari, me atësi Riza dhe amësi Halime, lindur më 29.07.1982 në Kutalli, Kuçovë, me nr. personal ID: I20729060L, është kandidat për Kryetar Bashkie në Bashkinë Kuçovë.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, subjekti vetëdeklarues ka plotësuar më datë 26.03.2023 dhe dorëzuar në datën 02.04.2023 pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve “Formularin e vetëdeklarimit”, regjistruar me numër unik BR-PS-17366.

1.1 Në rubrikën I të formularit të vetëdeklarimit, që ka të bëjë me të dhënat personale, ky subjekt nuk ka deklaruar gjeneralitete të mëparëshme veç atyre aktuale.

1.2 Në rubrikat e tjera të formularit të vetëdeklarimit, subjekti Kreshnik Hajradi, të gjitha pyetjeve i është përgjigjur me “JO” dhe nuk ka bërë asnjë deklaram në formular.

Veprimet e organi përgjegjës për administrimin e formularit të vetëdeklarimit:

2. Në zbatim të detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar dhe vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të

detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si organ përgjegjës, gjatë verifikimit të kryer për të dhënat e pasqyruara në formularin e vetëdeklarimit nga ky subjekt, ka vërejtur se:

2.1 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka administruar shkresën nr.220 prot., datë 04.04.2023 të Kualicionit Bashkë Fitojmë, me anë të të cilës kërkohet verifikimi i pastërtisë së figurës për kandidatin z.Kreshnik Hajdari, pasi sipas indicjeve rezultoi i dënuar në shtetin grek.

2.2 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime në lidhje me veprat e kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ndaj me shkresën nr.4100 prot., datë 24.04.2023, bazuar në nenin 8 të Ligjit nr.138/2015 dhe kreun V të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka përcjellë për kontroll të thelluar, në Prokurorinë e Përgjithshme, deklaratimet e bëra në formularin e vetëdeklarimit, nga shtetasi Kreshnik Riza Hajdari.

Depozitimi i kërkesës

3. Në Prokurorinë e Përgjithshme, kërkesa e përcjellë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, aktet bashkëlidhur dhe formulati i vetëdeklarimit të shtetasit Kreshnik Hajdari, janë protokolluar me nr.601, datë 24.04.2023 dhe po me këtë datë, është hedhur në sistem dhe është regjistruar në regjistrin e posaçëm me nr.20.

Verifikimi i kryer dhe rrethanat/fakti rezultuar:


4. Prokuroria e Përgjithshme, referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka kryer verifikimet përkatëse, duke iu drejtuar me kërkesa institucioneve shtetërore, nga janë administruar përgjigjet e marra, si dhe të dhënat dhe dokumentet, si më poshtë:

4.1 Në përgjigje të kërkesës sonë nr.601/3 prot., datë 26.04.2023, Sektori i Gjendjes Gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, bashkëlidhur shkresës nr.5476/1 prot., datë 02.05.2023, ka dërguar dokumentin “Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore” me nr.11 prot, datë 02.05.2023, me këtë përmbajtje:

- Shtetasi Kreshnik Hajdari, i biri i Riza dhe i Halime, lindur më datë 29.07.1982 në Kutalli, Berat, ALB, me numër personal I20729060L, është “i padënuar”.

4.2 Në përgjigje të kërkesës sonë nr.601/2 prot., datë 27.04.2023, Zyra e Gjendjes Civile në Njësinë Administrative Kuçovë 017, me shkresën nr.36 prot., datë 05.05.2023, ka informuar se:

- Shtetasi Kreshnik Riza Hajdari, me datëlindje 29.07.1982, emri i nënës Halime, vendlindja Kutalli, është i regjistruar në Regjistrin Kutalli nr.3 fleta 37, sipas aktit të lindjes me nr.351, dt 04.08.1982.



Vendim për subjektin deklarues **Kreshnik HAJDARI**

Në dt. 18.09.1986, me nr. Prot 64/1, transferohet familjarisht me leje banimi në zgjc Bashkia Kuçovë në regjistrin Themeltar "Llukan Prifti" nr. 12, fleta 6.

Në dt. 17.08.2006 me nr. Prot 353, Kreshnik Hajdari ndahet nga familja, duke kaluar në fletfamilje tjetër "Llukan Prifti" nr. 12 fleta 7.

Nuk ka asnjë ndryshim në të dhënat personale, sipas regjistrit themeltar të vitit 1974.

Në dt. 14.07.2016, me nr. Akti 54, ka lidhur martesën me shtetasen Irini Dhimo QOSJA e datëlindjes 07.07.1991, në zgjc Kuçovë.

Gjatë kërkimeve në regjistrin Kombëtar të vitit 2010, nuk figuron asnjë ndryshim në të dhënat personale për shtetasin Kreshnik Riza Hajdari, i datëlindjes 29.07.1982, emri i nënës Halime, vendlindja Kutalli, Berat.

Bashkëlidhur shkresës:

çertifikatë nga akti i lindjes me nr.351, dt. 04.08.1982, zgjc, Arshiva Berat, çertifikatën e gjendjes familjare zgjc Kutalli, çertifikatën e gjendjes familjare të zgjc Kuçovë, si dhe çertifikatë e marrë nga akti i martesës me nr. 54, dt. 14.07.2016, sipas regjistrit Kombëtar 2010.

4.2.1 Në përgjigje të kërkesës sonë nr.601/2 prot., datë 26.04.2023, Drejtoria e Dokumentave Biometrike dhe Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, me shkresën nr.4667/1 Prot., datë 08.05.2023 sqaron se, informacioni i kërkuar në lidhje me shtetasin Kreshnik Hajdari është dërguar nga zyra e gjendjes civile Kuçovë, Bashkia Kuçovë.

4.3 Me procesverbalin e datës 04 Maj 2023, është realizuar marrja me procesverbal "Për marrjen e dokumentave" dhe administrimi nga Kompania Koncensionare "ALEAT IDEMLIA" shpk., në formë të printuar të 3 formularëve dhe të 1 (një) CD, që përmbajnë të dhëna biometrike të shtetasit Kreshnik Hajdari me numër identiteti kombëtar (NID) I20729060L dhe me numër identifikues në system (ID): 8038653, 22509112 dhe 24195394, konfirmuar me shkresën nr. JAJ/23-0429 prot., datë 11 Maj 2023.

4.4 Në përgjigje të kërkesës sonë nr.601/5 prot., datë 05.05.2023, Departamenti i Policisë Kriminale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me shkresën nr.2931/4 prot datë 24.05.2023, ka informuar për shtetasin Kreshnik Hajdari, i biri i Riza dhe i Halime, lindur më 29.07.1982 në Kutalli, Dimal, Berat me nr. personal: I20729060L, se nga verifikimet e kryera në sistemet e tyre rezultojnë se:

a) Në modulën "Gjeneralitete nga Gjendja Civile", deri më datë 09.04.2009, figuron me identitetin **Kreshnik Hajdari**.

b) Në modulën Adam të sistemit TIMS, **nuk** figuron i regjistruar urdhër ndalimi apo arrestim në flagrancë në ngarkim të këtij shtetasi.

c) Nga verifikimet e kryera në sistemin Tims, rezultojnë se ky shtetas **nuk** rezultojnë i kthyer Deportiv apo i dëbuar nga territori i ndonjë shteti tjetër.

d) Nga verifikimi i kryer në sistemin AFS-2 të Interpolit rezultojnë se, për këtë subjekt **nuk** rezultojnë të ketë urdhër kërkimi ndërkombëtar.



Vendim për subjektin deklarues **Kreshnik HAJDARI**

e) Nga verifikimi i kryer në Arkivën Elektrinike të Zyrës Kombëtare Interpol Tiranë, rezulton se për këtë shtetas **nuk** ka regjistrime për arrestime/ndalime, apo vendime për masa sigurimi jashtë vendit.

f) Nga verifikimi i kryer në Arkivën Kriminale të Policisë së Shtetit, rezulton se ky shtetas **nuk** figuron i regjistruar për veprimtari kriminale.

Zyra Kombëtare Interpol Tirana për shtetasin *Kreshnik Hajdari* u ka kërkuar informacion zyrave homologe të vendeve të Evropës të Zonës 2 mbi aktivitetin e mundshëm kriminal të këtij shtetasi jashtë vendit dhe u ka dërguar kartelën daktiloskopike. Në rast të ndonjë përgjigje pozitive do tju informojmë në vazhdimësi.

4.4.1 Në vijim të kërkesës sonë nr.601/5 prot., datë 05.05.2023, Departamenti i Policisë Kriminale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me shkresën nr.2931/6 prot., datë 19.07.2023, informon për shtetasin *Kreshnik Hajdari*, i biri i *Riza* dhe i *Halime*, lindur më 29.07.1982 në *Kutalli, Dimal, Berat* me nr. personal: I20729060L, se Interpol Tirana njofton se ka marrë informacion nga Interpol Athina/Greqi ku thuhet se:

- shtetasi i mësipërm është regjistruar më datë 27.03.2017 nga Security Sub-Division of Joannina pasi është deportuar në Shqipëri.

4.5 Në përgjigje të kërkesës sonë nr.601/7 prot., datë 09.05.2023, Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, Durrës, Gjirokastrë, Vlorë, Kukës, Berat, Sarandë, Korçë, Shkodër, Lezhë, Fier, Dibër dhe Tiranë (shkresat nr. 6652/1 prot., datë 22.05.2023 dhe nr.7600/1 prot datë 03.06.2023), Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, kanë informuar se ndaj subjektit deklarues *Kreshnik Hajdari*:

-nuk janë regjistruar procedime penale;
-nuk ka qenë ose është në hetim;
-nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi dhe
-nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.

4.5.1 Në përgjigje të kërkesës sonë nr.601/7 prot., datë 09.05.2023, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, me shkresën nr.6696/1 prot., datë 13.06.2023, lidhur me shtetasin *Kreshnik Hajdari*, me atësi *Riza* dhe amësi *Halime*, lindur më datë 29.07.1982, në *Kutalli, Berat*, informon si më poshtë:

- Më datë 03.05.2023 është regjistruar procedimi penal nr. 80, mbi bazën e kallëzimit të Studio Ligjore "Jurisprudenca Group Albania" shpk, të bërë ndaj shtetasit *Kreshnik Hajdari*, për veprën penale të parashikuar nga neni 190/2 i Kodit Penal.

Ky procedim penal është në fazën e hetimeve dhe emri i *Kreshnik Hajdari* **nuk** rezulton të jetë i regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në lidhje me këtë procedim.

- Më datë 29.05.2023 është regjistruar procedimi penal nr.131, mbi bazën e kallëzimit të subjektit politik *Partia Demokratike e Shqipërisë*, të bërë ndaj shtetasit *Kreshnik Hajdari* etj, për veprën penale të parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal.

Vendim për subjektin deklarues **Kreshnik HAJDARI**

Ky procedim penal është në fazën e hetimit dhe emri i shtetasit Kreshnik Hajdari **nuk** rezulton të jetë i regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në lidhje me këtë procedim.

- Pas verifikimit të kryer në regjistrin e njoftimit të veprave penale të ish-Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, **nuk** rezulton që në emër të shtetasit Kreshnik Hajdari, atësia Riza, amësia Halime, lindur më datë 29.07.1982, në Kutalli, Berat, të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

4.5.2 Në përgjigje të kërkesës tonë nr.601/7 prot., datë 09.05.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën nr.664/3 prot., datë 12.10.2023 përcjell dokumentacionin dërguar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Bashkëlidhur është dërguar vendimi penal nr. 262., datë 21.10.2021 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

Referuar këtij vendimi, Kreshnik Hajdari, në cilësinë e kërkuarit ka kërkuar nga kjo gjykatë ndryshimin e vendimit nr.192 datë 29.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat me objekt Kundërshtim i vendimit datë 15.06.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat "Për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. 1714/2021" dhe kthimin për hetime të mëtejshme.

Gjykata e Apelit Vlorë ka pranuar kërkesën dhe ka vendosur shfuqizimin e vendimit të datës 15.10.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit penal dhe realizimin e detyrave sipas pjesës arsyetuese të këtij vendimi

4.6 Në përgjigje të kërkesës sonë nr.601/23 prot., datë 31.05.2023, Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr.2037/1 prot./K.N, datë 16.06.2023, lidhur me shtetasin shqiptar Kreshnik Hajdari informon se nga ana e saj janë transmetuar kërkesat tona drejtuar autoriteteve greke të drejtësisë.

4.6.1 Me shkresën nr. 2037/6 Prot/KN., datë 24.10.2023, Ministria e Drejtësisë transmeton përgjigjen me nr. Ref: 45030 φ.14000, datë 28.09.2023 të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Greqisë.

Në aktet ardhura nga autoritetet greke të drejtësisë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, të përkthyer zyrtarisht në gjuhën shqipe, rezultojnë të kenë ardhur:

- ✓ Shkresa e Ministrisë së Drejtësisë e Republikës së Greqisë me Nr.Prot: oik 45030 FEA 14000, Athinë më 28.09.2023;
- ✓ Shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Janinë me Nr.Prot 1849, 1918, Janinë më 29 Gusht 2023;
- ✓ Shkresa e Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë, me Nr. Prot. 619/2023, Janinë, 20-07-2023, Numri i ndihmës Juridike 11-202;
- ✓ Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë/Gjykata Penale me Një Anëtar, me Nr. 3286/23-6-1999 - (dy fletë);
- ✓ Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Janinë me Nr.Prot.2071, Janinë më 18 Korrik 2023, drejtuar Prokurorisë së Apelit Janinë;
- ✓ Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Parë Prevezë me Nr.Prot.1932, Preveza më 24-7-2023;

- ✓ Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Parë Arta me Nr.Prot.6340, Arta më 31-7-2023;
- ✓ Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Janinë/Departamenti i Kallëzimeve, me Nr.Prot.2239, Janinë më 04 Gusht 2023, drejtuar Prokurorisë së Apelit Janinë;
- ✓ Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Janinë/Departamenti i Kallëzimeve me Nr.Prot.2161, Janinë më 28 Korrik 2023, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë/Seksionit Penal;
- ✓ Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Janinë/Departamenti i Kallëzimeve me Nr.Prot.948, Janinë më 03-08-2023, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë, Departamentit të Kallëzimeve;
- ✓ Shkresë e Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Drejtësisë, Marëdhëniet Juridike Ndërkombëtare dhe të Drejtave të Njëriut, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Organizimit dhe Funksionimit të Drejtësisë, Departamenti i Organizimit të Gjykatave dhe Statusi i Shërbimit të Zyrtarëve Gjyqësor në Republikën e Greqisë, me Nr.Prot 63394, Athinë më 8-1-2023 (dy fletë);
- ✓ Procesverbal i Komisionit Numër 1/2020 i Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë, Janinë më 12 Mars 2020 (dy fletë)
- ✓ Shkresë e Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë Nr.Prot 619/2023, Janinë më 20-07-2023, drejtuar Prokurorisë së Apelit Janinë;
- ✓ Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë/Gjykata Penale me Një Anëtar, me Nr. 3286/23-6-1999 - (dy fletë);

Në aktet e administruara dhe konkretisht referuar vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë/Gjykata Penale me Një Anëtar, me Nr. 3286/23-6-1999 rezulton se:


- Në prani të të pandehurve ...14) Hajdari Kreshnik, i biri i RIZA dhe i HALIME, i lindur më 29-7-1982 në Berat, Shqipëri, puntor (i bashkëgjykuar i mitur), Gjykata shpall fajtor secilin nga personat madhorë të përgjegjshëm penalisht dhe shkaktar sejcilin nga personat e mitur të përgjegjshëm penalisht ("ka kryer një vepër") për shkeljet: Hyrja në territorin grek pa ruajtur formalitetet ligjore përkatëse (shkelje e nenit 4 §§ 1 dhe 3 të Ligjit 1975/1991).

Veprimet u konstatuan në Despotiko të Prefekturës së Janinës, më 23 Qershor 1999 në orën 02:30. Dënon secilin nga personat madhorë penalisht të pandehur, të shpallur fajtor me: Katër (4) muaj burgim.

Dënon secilin nga të pandehurit e mitur të shpallur fajtorë me: Masa riedukuese e qortimit. Konverton në dënime me gjobë të gjitha dënimet me burg të vendosura tashmë më sipër të pandehurve të dënuar (të gjithë) dhe përcakton shumën e konvertimit për çdo ditë burgim në një mijë e pesëqind (1500) dhrahmi.

Urdhëron dëbimin e menjëhershëm të të gjithë të pandehurve madhorë të huaj të dënuar me burg dhe më tej, pezullon për një kohë të pacaktuar (sipas nenit 90 paragraf 2 të Kodit Penal) dënimin me burg të dhëna ndaj tyre, me kusht që të ekzekutohet menjëherë dëbimi i tyre tashmë i urdhëruar.

- Sipas procesverbalit Numër 1/2020 - PROCESVERBAL I KOMISIONIT i mbajtur në Gjykatën e Shkallës së Parë Janinë, është vendosur shkatërrimi i arkivave të Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë, të cilat nuk kanë asnjë vlerë zyrtare historike përfshirë edhe dosjen me të gjykuar subjektin Kreshnik Hajdari.



- Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Janinë/Departamenti i Kallëzimeve, me Nr.Prot.2239, Janinë më 04 Gusht 2023, drejtuar Prokurorisë së Apelit Janinë, citon se në ekzekutim të letërporosisë tuaj me nr.1906, 1908, 1918/25.07.2023 ju referojmë se në përputhje me shkresën nr.prot 948/03.08.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë Janinë është e panumtur dhënia e kopjeve, pasi dësja për vendimin nr.3286/1999 e Gjykatës së Shkallës me Një antar Janinë, ESHTË ASGJESUAR.

Vepra penale për të cilën është dënuar shtetasi Kreshnik Hajdari, “Hyrja në territorin grek pa ruajtur formalitetet ligjore përkatëse” (shkelje e nenit 4 §§ 1 dhe 3 të Ligjit 1975/1991), me Ligjin nr.8279, datë 15.01.1998, është parashikuar si “Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror”, nga neni 297 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Baza ligjore:

5. Për sa më sipër, pas kryerjes së gjithë verifikimeve të mundshme brenda dhe jashtë vendit, duke i konsideruar këto verifikime të plota, bazuar në përcaktimet e nenit 8, pikat 1, 2 të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe në përcaktimet e pikës 3, gërma “ç”, Kreu III-të dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Kreut V të Vendimit të Kuvendit Nr.17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

V E N D O S A :

1. Miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin vetëdeklarues Kreshnik Hajdari, me atësi Riza dhe amësi Halime, lindur më 29.07.1982 në Kutalli, Kuçovë, me nr personal ID: I20729060L, kandidat për Kryetar Bashkie, në Bashkinë Kuçovë, i cili:

i. Nuk rezulton të ketë gjeneralitete të tjera në përbërësit e gjendjes civile, përveç atyre të deklaruara në formular apo të ndryshme nga ato të deklaruara;

ii. Rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë Nr. 3286/23-6-1999, nga Gjykata e Shkallës së Parë Janinë/Gjykata Penale me Një Anëtar, e cila ka vendosur:

Në prani të të pandehurve ...14) Hajdari Kreshnik, i biri i RIZA dhe i HALIME, i lindur më 29-7-1982 në Berat, Shqipëri, puntor (i bashkëgjykuar i mitur): Shpall fajtor secilin nga personat madhorë të përgjegjshëm penalisht dhe shkaktar sejcilin nga personat e mitur të përgjegjshëm penalisht (“ka kryer një vepër”) për shkeljet: Hyrja në territorin grek pa ruajtur formalitetet ligjore përkatëse (shkelje e nenit 4 §§ 1 dhe 3 të Ligjit 1975/1991).

Dënon secilin nga personat madhorë penalisht të pandehur, të shpallur fajtor me: Katër (4) muaj burgim.

Dënon secilin nga të pandehurit e mitur të shpallur fajtorë me: Masa riedukuese e qortimit.



Konverton në dënime me gjobë të gjitha dënimet me burg të vendosura tashmë më sipër të pandehurve të dënuar (të gjithë), dhe përcakton shumën e konvertimit për çdo ditë burgim në njëmijë e pesëqind (1500) dhrahmi.

Urdhëron dëbimin e menjëhershëm të të gjithë të pandehurve madhorë të huaj të dënuar me burg dhe më tej, pezullon për një kohë të pacaktuar (sipas nenit 90 parag.2 të Kodit Penal) dënimin me burg të dhëna ndaj tyre, me kusht që të ekzekutohet menjëherë dëbimi i tyre tashmë i urdhëruar.

iii. Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;

vi. Rezulton që në vitin 1999 të ketë qënë në gjykim nga Gjykata e Shkallës së Parë Janinë për: Hyrje në territorin grek pa ruajtur formalitetet ligjore përkatëse (shkelje e nenit 4 §§ 1 dhe 3 të Ligjit 1975/1991).

v. Nuk rezulton të ketë qënë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale.

vi. Nuk rezulton që ndaj tij të jetë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale.

vii. Nuk rezulton që ndaj tij të jetë lëshuar urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.

viii. Nuk rezulton që ndaj tij të jetë marrë masa e dëbimit nga një shtet i huaj.

2. Ky vendim mbi rezultatet e verifikimit t'i njoftohen brenda 3 (tre) ditëve Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, i cili si organ kompetent në zbatim të nenit 12 e 13 të Kreut V të Vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", duhet të shqyrtojë nëse janë evidentuar të dhëna që përfshihen në sferën e kufizimeve të nenit 2 të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe në vijim, të vlerësojë nëse ato janë brenda periudhës së ndalimit të përcaktuar në nenin 4 të po këtij ligji.

PROKURORI

KOSTAQ BELURI

